



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevc, Nr. 8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

KOMUNIKATË PËR MEDIA

9 Dhjetor, 2009

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHPALL REZULTATET E VALËS 41 TË PRIVATIZIMIT

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 41 të privatizimit, shpalli ofertuesit e përkohshëm, fitues të Ndërmarrjeve të Reja të tenderuar përmes metodës së Spin-off-it të Rregullt.

Gjithsej 29 Ndërmarrje të Reja ishin në dispozicion për shitje.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKP-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, nga ora 13:00 deri në ora 14:00.

Gjithsej janë pranuar 82 oferta.

Vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte €7,966,890.

Agjencia Kosovare e Privatizimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, në pritje të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

FUND